



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
INSTITUTI I SHËNDETIT PUBLIK

BULETINI JAVOR I SËMUNDSHMËRISË INFEKTIVE - ALERT

JAVA 22 26 Maj – 2 Qershor 2024

Për këtë periudhë, kanë raportuar 36 NJVKSH ose 100% (=36/36) e tyre

36 NJVKSH ose 100% (=34/36) e tyre kanë raportuar në platformën dixhitale SISI:

BERAT, BULQIZË, DEVOLL, DIBËR, DURRËS, ELBASAN, FIER, GJIROKASTËR, GRAMSH, HAS, KAVAJË, KOLONJË, KORÇË, KRUIJË, KUÇOVË, KUKËS, KURBIN, LEZHË, LIBRAZH, LUSHNJE, MALLAKASTËR, M. MADHE, MAT, MIRDITË, PEQIN, PËRMET, POGRADEC, PUKË, SARANDË, SHKODËR, SKRAPAR, TEPELENË, TIRANË, TROPOJË, VLORË.

Pa raportim brenda afatit, 0 NJVKSH ose 0% (=0/36) e tyre:

NUMRI TOTAL I RASTEVE TË SINDROMAVE TË SURVEJANCËS “ALERT” NË JAVËN 22

	JAVA 22
DIARRE PA GJAK	1.469
DIARRE ME GJAK	0
INF. RESP. TE SIPËRME	7.173
INF. RESP. TE POSHTËME	2.916
RASH ME TEMPERATURË	38
VERDHEZA	0
ETHE E ZGJATUR E PASHPJEGUAR (> 3 JAVE)	0
ANOMALI KONGENITALE	0
KONJUKTIVIT AKUT TEK NEONATËT	0
Numri i Njësive Raportuese	422
% e Njësive Raportuese	96% (422/442)

Rash me temperaturë

Nga hetimi epidemiologjik dhe konsultat me mjekët e familjes, mjekun infeksionist dhe atë epidemiolog rastet e mëposhtëme nuk janë të dyshuar për fruth, rubeolë apo linë e majmunit, por për varicelë dhe dorë-këmbë-gojë:

Fier – 1 rast


Pogradec – 2 raste

Tiranë – 26 raste


Vlorë – 9 raste

Infeksione respiratore

Trendi në kohë i Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme sipas javëve




Shpërndarja e Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme sipas Grup-moshave




Prirja në kohë e Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme paraqitet e qëndrueshme në javën 22 krahasuar me javën paraardhëse, java 21.

Diarre pa gjak

Trendi në kohë i Diarreve pa Gjak sipas javëve




Shpërndarja e Diarreve pa Gjak sipas Grup-moshave




Prirja në kohë e “Diarreve pa gjak” paraqet ritje në javën 22 krahasuar me javën paraardhëse, java 21.

Prirja e “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” në javët 15 – 22 të viteve 2023 dhe 2024. Numri i rasteve.




Në javën 22 të vitit 2024 vërehet prirje e qëndrueshme e numrit të infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme.


Frekuenca e “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” sipas grupmoshës. Incidenca (raste/10.000)



Frekuenca e hasjes së “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” sipas NJVKSH në javën 21 dhe 22 / 2024. Incidenca (raste/10.000)




Prirja e “Diarreve pa Gjak” në javët në javët 15 - 22 të viteve 2023 dhe 2024. Numri i rasteve.



Në javën 22 të vitit 2024 vërehet e prirje në ritje e numrit të rasteve “Diarre pa gjak”.

**Frekuenca e hasjes së “Diarreve pa gjak” sipas NJVKSH në javën 21 dhe 22 / 2024.
Incidenca (raste/10.000)**



Nga komunikimi me NJVKSH shumica e rasteve janë raportuar nga Urgjenca e Spitaleve dhe janë të shpërndara, pa grumbullime dhe lidhje epidemiologjike ndërmjet tyre.

Ngjarje kombëtare

1. *Fruthi, situatë epidemiologjike*

- Theksojme se nuk ka ndryshim në situatën epidemiologjike të fruthit në vend.
- Për periudhën Janar – 3 qershor 2024 janë testuar 183 raste të dyshuar me fruth nga të cilët janë konfirmuar 40 (21.8%) raste me Fruth.
- Nga këto 37 raste janë konfirmuar në laboratorin kombëtar të referencës të virologjisë në ISHP dhe 3 raste janë të konfirmuar sipas perkufizimit të rastit mbështetur në shenjat klinike dhe epidemiologjike.
- Incidenca e sëmundjes në vend është 1.4 raste/100 000 banorë.
- Rastet i perkasin moshes nga 0-38 vjeç (mediana 5 vjeç).
- Numri më i lartë i perket grupmoshës 5-9 vjeç me 30% të totalit të rasteve të konfirmuar
- Incidenca më e lartë është në grupmoshën 2-4 vjeç me 14.7 raste/100 000 banorë.
- Nga 40 rastet e konfirmuar 22 (55%) prej tyre janë shtruar në spital dhe 18 raste (45%) kanë qëndruar në kushte shtëpie.
- 22 raste janë të pavaksinuar (55%) dhe 18 raste (45%) janë të vaksinuar me të paktën një dozë vaksine.
- Numri më i lartë i rasteve i perket Tiranës 27 raste ose 67.5% e totalit.
- Incidencën më të lartë e ka Durrësi me 4.7 raste/100 000 banorë.

Ngjarje ndërkombëtare

2. *Gripi i shpendëve shumë patogjenik A(H5N1) në bagëti dhe rastet e lidhura me të në njerëz –Shtetet e Bashkuara - 2024*

- Një rast i tretë në njerëz i gripit të shpendëve shumë patogjen (HPAI) A(H5) i shoqëruar me Shpërthimin e vazhdueshëm në shumë shtete të A(H5N1) në bagëti në Shtetet e Bashkuara u raportua më 30 Maj 2024 në shtetin e Miçiganit.
- Që nga 31 maj 2024, janë raportuar tre raste humane të gripit të shpendëve A(H5N1) në punëtorë në fermat e qumështit me lopë të infektuara. Viruset janë izoluar nga dy rastet e para dhe i perkisnin HA 2.3.4.4b, gjenotipit B3.13, ndërsa rezultatet e analizës gjenomike janë në pritje për rastin e tretë.
- Deri më sot, survejanca rutinë e bazuar në popullatë nuk ka zbuluar ndonjë rritje në komunitet.
- Shpërthimi i gripit të shpendëve shumë patogjen (HPAI) A(H5N1) në gjedhë është ende në vazhdim, me 69 ferma të prekura në nëntë shtete të Shteteve të Bashkuara që nga 30 maj 2024.

3. Sëmundja invazive meningokokale e importuar në udhëtarët që kthehen nga Mbretëria e Arabise Saudite - 2024

- Midis 23 prillit dhe 29 majit 2024, 13 raste të sëmundjes invazive meningokokale (IMD), serogrupi W është raportuar nga Franca (4), Norvegjia (1), Mbretëria e Bashkuar (MB) (3), dhe Shtetet e Bashkuara (SHBA) (5).
- Rastet janë të lidhura epidemiologjikisht me praktikat fetare në zonat e Umres në Mbretërinë e Arabisë Saudite (KSA).
- Sekuenca të tëra gjenomi nga ngjarja e depozituar në pubmlst.org tregojnë se një sekuenca nga Franca, katër nga MB dhe një nga SHBA, të marra nga mostrat e mbledhura në vitin 2024, formojnë një nën-grup shumë të ngushtë.
- Vaksinimi kundër meningokokut rekomandohet për ata që udhëtojnë drejt ASK-së Umre dhe për haxhinjtë e haxhit.

4. Tubimi masiv - Haxhi - Mbretëria e Arabisë Saudite – 2024

- Në vitin 2024, pelegrinazhi vjetor i Haxhit Islamik do të bëhet në Mbretërinë e Arabisë Saudite ndërmjet 14 dhe 19 qershor.
- ECDC do të monitorojë këtë ngjarje përmes inteligjencës së saj epidemike për aktivitetet e grumbullimit masiv ndërmjet 10 dhe 26 qershor në bashkëpunim me CDC dhe Organizatën Botërore të Shëndetësisë, Zyra Rajonale për Mesdheun Lindor (OBSH EMRO).
- Probabiliteti i infektimit për qytetarët e BE/ZEE gjatë Haxhit konsiderohet i ulët nëse respektohen rekomandimet. Probabiliteti dhe ndikimi konsiderohet i moderuar për njerëzit me sëmundje shoqërore, të moshuarit dhe gratë shtatzëna.

5. Chikungunya dhe Dengue - Monitorimi i shpërthimeve globale

- Që nga fillimi i vitit 2024, rreth 240 000 raste të sëmundjes së virusit chikungunya (CHIKVD) dhe 90 vdekje janë raportuar në mbarë botën. Gjithsej 18 vende raportuan raste CHIKVD nga Amerika (11), Azia (6) dhe Afrika (1). Nuk ka pasur raste autoktone të CHIKVD raportuar në Evropë në vitin 2024.
- Që nga fillimi i vitit 2024, mbi shtatë milionë raste të dengës dhe mbi 3 000 vdekjet të lidhura me dengën janë raportuar globalisht. Ende nuk është raportuar asnjë rast autoktone i dengës Evropa në 2024.
- Mundësia aktuale e shfaqjes së ngjarjeve lokale të transmetimit të viruseve chikungunya dhe dengës në zonat ku vektori është i pranishëm në kontinentin e BE/ZEE është i ulët, pasi kushtet mjedisore nuk janë ende të favorshme për aktivitetin e vektorit dhe replikimin e virusit në vektorë.

- Mjekët në BE/ZEE duhet të jenë të vetëdijshëm për rrezikun e rritur të sëmundjes së dengës tek udhëtarët nga vendet e prekura që paraqiten me simptoma të përputhshme për të siguruar diagnozën e shpejtë dhe menaxhimin klinik të rasteve.

6. Poliomieliiti – Monitorimi mujor i shpërthimeve globale

- Në vitin 2024 dhe që nga 28 maji, gjashtë raste të paralizës akute flakcide (AFP) për shkak të infeksionit nga poliovirusit të egër janë raportuar në Pakistan (3) dhe Afganistan (3).
- Në vitin 2024 dhe që nga 28 maji, në përgjithësi, 3 raste të AFP të shkaktuara nga cVDPV1 u raportuan nga DRC (rritje me 2 raste), dhe 58 raste të AFP të shkaktuara nga cVDPV2 u raportuan në 11 vende, një rritje me 44 raste në periudhën raportuese.